Numër: 01-554 Datë: 31.07.2025

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 merr:

V E N D I M

I. **Rikreditohet dhe rivalidohet,** "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës - IADK ". Adresa: Fshati Sfaraçak i Ulët nr.11, 42000 Vushtrri, për periudhën pesë (5) vjeçare, (25.07.2025 - 25.07.2030), me kualifikimet:

1. **"Konservuesit e Frutave, Perimeve dhe të Ngjashme",** kualifikim i bazuar në Kualifikime Kombëtare Profesionale. Numër total i kredive trembëdhjetë (13), niveli III sipas KKK-së. "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës - IADK"mund të realizojë programin si vijon: numri i kandidatëve brenda një viti gjashtëdhjetë (60), grupe totale brenda një viti katër (4). Kandidatët brenda grupit teorik pesëmbëdhjetë (15). Kandidatët brenda grupit praktik pesëmbëdhjetë (15).

2. **"Qumështar",** kualifikim i bazuar në Kualifikime Profesionale. Numër total i kredive trembëdhjetë (13), niveli III sipas KKK-së. "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës - IADK " mund të realizojë programin si vijon: numri i kandidatëve brenda një viti gjashtëdhjetë (60), grupe totale brenda një (1) viti, katër (4). Kandidatër brenda grupit teorik pesëmbëdhjetë (15). Kandidatët brenda grupit praktik pesëmbëdhjetë (15).

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës - IADK ". Adresa: Fshati Sfaraçak i Ulët nr.11, 42000 Vushtrri për kualifikimin **"Konservuesit e Frutave, Perimeve dhe të Ngjashme"**, dhe **"Qumështar"**, niveli III KKK-së, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ka caktuar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim.

Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit më 12.03.2025 për kualifikimet: **"Konservuesit e Frutave, Perimeve dhe të Ngjashme"** dhe **"Qumështar"**, niveli III dhe vizitës së realizuar më: 19.05.2025, pas përfundimit të procesit vlerësues, ka përpiluar raportet më 25.05.2025.

Bazuar në analizën e dosjes së aplikimit dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitës, si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, çështja është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve mbështeten në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit, si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitave tek pala aplikuese.

AKK, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014, për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK";
- Arkivit të AKK.